**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **613-23-1636-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Blerja e aparateve biokimike dhe hematologjike për Qendren Kryesore të Mjekësisë Familjare- Lipjan**

# ANKESË

## 1. Identifikimi i ankuesit*

| | |
|---|---|
| Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj | **Agani L.t.d SH.P.K.** |
| NUI | **811282706** |
| Adresa | **Magj. Prishtine-Ferizaj, Km.5 Graçanice** |
| Vendi | **PRISHTINE** |
| Kodi postar | **10000** |
| Numri Telefonit | **038 767006** |
| Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj | **Argjend Olluri** |
| Adresa elektronike | **diagnostics@agani.net** |
| Data e parashtrimit të ankesës | **30.03.2023** |

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

Ankesa i përket grupeve:

**Blerja e aparateve biokimike dhe hematologjike për Qendren Kryesore të Mjekësisë Familjare- Lipjan**

**Aktiviteti i prokurimit nga Kuvendi Komunal ne Lipjan per blerje te pajisjeve laboratorike.**

**Titulli i tenderit: Blerja e aparateve biokimike dhe hematologjike për Qendren Kryesore të Mjekësisë Familjare- Lipjan**

**Nr i prokurimit 613-23-1636-1-2-1**

**Data e dorezimit te njoftimit te kontrates ne KRPP: 03.03.2023**

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

***Po*** ☐ ***Jo*** ☒

## *6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve*

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.*

**Kerkese per rishqyrtim kemi paraqitur tek Autoriteti Kontraktues me daten 23.03.2023.**

**Ne kerkesen per rishqyrtim kemi paraqitur ankesat tona dhe dispozitat ligjore te shkelura te ligjit per Prokurim Publik nga Autoriteti Kontraktues.**

**Ne kerkesen per Rishqyrtim kemi paraqitur ne detaje deklaraten mbi faktet e argumentuara.**

**Autoriteti kontraktues ka pranuar kerkesen tone dhe i eshte pergjigjur negativisht me daten 27.03.2023.**

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:

Neni 5 : Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Neni 6: Barazi ne trajtim/ jo-diskriminim.

Neni 28: Specifikimet teknike.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Ne lidhje me aktivitetin e prokurimit kemi njoftuar autoritetin kontraktues për shkeljet ligjore ndaj Ligjit te prokurimit publik. Autoriteti kontraktues ka refuzuar kërkesën tone për rishqyrtim përkundër shkeljeve për te cilat është njoftuar.

Kërkesat tona kane qene si ne vijim:

Autoriteti kontraktues ne specifika kërkoi qe pajisja biokimike te ketë dy krah punues.

Duke pas parasysh qe janë bere shume kufizime ne tenderin ne fjale, kërkesa e mësipërme ndikon qe te eliminohet konkurrenca.

Ne kemi kërkuar qe te na mundësohet te ofertojmë pajisen tone me specifikat si ne vijim:

**Konstruksion special te pastrimit dhe rezolucion 0.0001 Abs.**

Autoriteti kontraktues pas sqarimeve te vendosjes se specifikave ne fjale nuk ka aprovuar kërkesën tone ne te cilën ne kemi sqaruar qe po ofertojmë pajisje me te avancuara. Autoriteti kontraktues gjate sqarimit ka cituar qe qëllimi i vendosjes se specifikes ne fjale ka qene arritja e saktësisë me te larte e analizave. Ndërsa specifikat te cilat i kemi ofruar për aprovim dëshmojnë për saktësinë me te larte te pajisjes sonë kundrejt pajisjes se kërkuar nga AK.

Pajisja jone posedon rezolucion me te larte e cila ndikon ne saktësinë dhe precizitetin me te larte te pajisjes.

Përkundër qe po ofertojmë pajisje me te avancuar, autoriteti kontraktues do bej eliminimin pasi qe ka vendos specifik diskriminuese paraprakisht për te pamundesuar konkurrencë.

Ne kërkese ka qene po ashtu qe tanku i ujit dhe mbeturinave te jete brenda njësisë se analizatorit.

Specifika ne fjale është arsyetuar me hapësirat e vogla te laboratorëve te QMF-ve ne Lipjan.

Ne kemi njoftuar AK qe specifika ne fjale është vendosur për eliminim te konkurrencës pasi qe pajisjet tona posedojnë dimension me te vogël, mirëpo ato do refuzohen si shkak i specifikes qe është vendosur paraprakisht për eliminim te konkurrencës.

Te dy kërkesat se bashku ndikojnë qe te ulet konkurrenca përveç për pajisen për te cilën është publikuar procedura e tenderimit.

Andaj ne baze te sqarimit ne detaje për autoritetin kontraktues ne kërkesën për rishqyrtim ne lidhje me mundësitë me te mira te cilat po i ofertojmë, autoriteti kontraktues vendosi te refuzohet kërkesa dhe te procedohet me shkeljet ligjore.

Ne ketë mënyre po mundësohet një monopol i pajisjes te kërkuar nga autoritetit kontraktues duke dëmtuar fondet publike te komunës se Lipjanit.

**9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
*e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
*f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*